

AGRON FICO

BOTIMET FOLKLORIKE SHQIPTARE NË SHEKULLIN XIX
SHPREHJE E NDËRGJEGJES KOMBËTARE

Në shekullin XIX, në luftën çlirimtare të popullit shqiptar, u shënua një kthesë me rëndësi. Ndryshe nga shekujt e mëparshëm, qysh në gjysmën e parë të shekullit XIX, në kryengritjet e popullit shqiptar filloi të depërtojë ndërgjegja e Luftës nacionalçlirimtare për një shtet shqiptar më vete. Kjo ndërgjegje e re erdhi duke u zhvilluar përherë e më tepër: ajo nxiti veprimtarinë politike, shoqërore e kulturele të vendit, vuri në lëvizje tërë klasat dhe shtresat shoqërore të Shqipërisë. Në këtë kohë, idetë iluministe, që po fitonin gjithnjë e më tepër truall në Ballkan, patën edhe në Shqipëri një jehonë të rëndësishme; ato ishin një goditje e fortë kundër sundimit të ideologjisë mesjetare. Iluministët ballkanas theksonin nevojën e flakjes së gjuhëve kishëtare: greqishtes dhe sllavishtes së vjetër, të përtëritjes së gjuhës amtare të popujve dhe të mbështetjes në thesarin e traditave popullore, si bazë për zhvillimin e mëtejshëm të ndërgjegjes së tyre kombëtare.

Në zgjimin dhe forcimin e ndërgjegjes sonë kombëtare, si një nevojë patriotike, lindi dhe u zhvillua tek ne një veprimtari e gjërë folklorike, që gjeti shprehje konkrete në botimet e ndryshme të visave popullore.

Këto përpjekje, që bëheshin edhe në këtë fushë, i kishin rrënjët në nevojat objektive, që paraqiste me forcë gjithnjë më të madhe gjëndja e atëhershme në Shqipëri.

Dihet se regjimi i egër turk kishte shpërthyer një reaksion të rreptë kundër çdo shfaqjeje kulturore shqiptare, duke përfshirë dhe letërsisë gojore popullore. Zbulimi dhe propagandimi i folklorit, në këto rrethana, mirrte një kuptim politik e patriotik, që synonte në forcimin e ndërgjegjes kombëtare, në ushqimin e saj në traditat e lashta e të lavdishme të popullit shqiptar dhe në flakjen poshtë të shpifjeve të armiqve të çështjes shqiptare, që mohonin jo vetëm ekzistencën e aftësisë të tij krijuese, por edhe vetë ekzistencën e tij si popull.

Ndër arbëreshët e Italisë, që u vendosën aty para, po sidomos pas vdekjes së heroit kombëtar — Gjergj Kastriot Skënderbeut, nga fundi i shek. XVIII e fillimi i shek. XIX, nisi një lulëzim i folkloristikës në drejtime të kërkuarve të folklorit oral. Duke mbledhur e botuar poema, ballada, përralla, duke gjurmuar elemente të një mitologjie shqiptare, arbëreshët synonin të zbulonin vlerat shpirtërore të së kaluarës së ndritur, në ndihmë të Rilindjes kombëtare.

Puna e palodhur e mjaft patriotëve të Rilindjes, si De Rada, Thimi Mitkua, Zef Jubani, Spiro Dineja etj., të cilët i dhanë folklorit

një rëndësi të veçantë patriotike dhe edukative, i shërbeu zgjimit kombëtar, në kushtet e hovit të lëvizjes për çlirim.

Më një anë, pjesëmarrja e shqiptarëve në kryengritjet e vitit 1821 në Ballkan, radhitja e arbëreshëve të Italisë në vijën e parë të luftës së popullit italian kundër burbonëve dhe austriakëve pushtues, si dhe në lëvizjen për bashkimin e Italisë e në atë garibaldine, tregojnë lidhjen e çështjes shqiptare me çështjen e çlirimit të popujve të tjerë fqinj. Lëvizja kulturore, që pararendi dhe shoqëroi kryengritjet e herë-pashershme, shënoi me të vërtetë një përparim në vitet 60 të shek. XIX, sidomos në terrenin arbëresh të Italisë.

Nga ana tjetër, nën ndikimin e romantizmit dhe të interesit që shfaqte në gjysmën e parë të shek. XIX shkenca gjuhësore evropiane për gjuhën shqipe, një plejadë intelektualësh arbëreshë, midis të cilëve shquheshin Jeronim De Rada, Dhimitër Kamarda, Vinçenc Dorsa, etj., iu dhanë gjërisht si mbledhjes ashtu dhe botimit të thesareve të gjuhës dhe të kulturës së popullit shqiptar.

Në vitin 1866 u botuan dy përmbledhje të rëndësishme të folklorit arbëresh-shqiptar, njëra: «*Rapsodia d'un poema albanese*» (Rapsodi të një poeme arbëreshe) prej Jeronim De Radës (1814-1903) dhe tjetra prej filologut të shquar arbresh Dhimitër Kamarda (1821-1882). «*Appendice al saggio di Grammatologia comparata sulla lingua albanese*» (Shtojcë e sprovës së Gramatologjisë krahasuese mbi gjuhën shqipe). Nëpërmjet pasurisë së madhe artistike që paraqiste folklori, të dy studjuesit arbëreshë u përpoqën me sukses të tërhiqnin vëmendjen e opinionit publik botëror mbi popullin shqiptar dhe lashtësinë e tij si dhe mbi të drejtën e tij për t'u njohur si komb më vehte.¹⁾

De Rada i dha përmbledhjes së vet folklorike titullin e bujshëm «*Rapsodi të një poeme arbëreshe*», duke pasur idenë se këto këngë janë fragmente të një poeme të madhe kombëtare që u thërmua nga koha.

De Rada në «*Rapsodi të një poeme arbëreshe*» si dhe gjatë tërë aktivitetit të tij, ruajti idenë themelore të kërkimeve dhe botimeve folklorike — *patriotizmin*. Prandaj ai qëndron një pararendës i shquar i Mitkos, një figurë e madhe në historinë e folkloristikës shqiptare, një përhapës i guximshëm i këngës popullore në shërbim të viteve politike të Rilindjes sonë kombëtare.²⁾

Botimi i Rapsodive të De Radës më 1866 entuziazmoi jo vetëm shqiptarët, po edhe miqtë e dashamirët e popullit tonë. Shkrimtarja e njohur Dora D'Istria e quajti këtë vepër si një epike kombëtare origjinale, si histori e patriotëve shqiptarë. Duke u mbështetur mbi këto këngë dhe mbi ato të Dh. Kamardës etj., ajo botoi më 15 maj 1866, në të përkohshmen *Revue des deux mondes* artikullin e famshëm: *La nationalité albanaise d'après les chants populaires — Les albanais des deux cotés de l'Adriatique* (Kombësia shqiptare si pas këngëve popullore — Shqiptarët e të dy anëve të Adriatikut). Në këtë artikull Dora d'Istria kishte për qëllim të argumentonte qenjen e kombësisë sonë, lashtësinë e popullit shqiptar, trashëgimet e tij kulturore-artistike, të çmonte gjuhën e lashtë e të bukur shqipe, letërsinë tonë të pasur gojore. Ajo vinte në dukje se këngët popullore historike shqiptare,

1) *Historia e Shqipërisë II*, Tiranë 1965, f. 101.

2) Zihni Sako, *Jeronim De Rada dhe veprimtaria e tij në fushën e kërkimeve dhe botimeve folklorike* (AIF, f. 7).

e në mënyrë të veçantë rapsoditë e botuara nga De Rada, që kishin si figurë qendrore Skënderbeun, flisnin jo vetëm për aftësinë krijuese artistike të një populli me kulturë të lashtë, por *përbënin edhe një dokument historik*, i cili dëshmonte për dashurinë për liri e pavarësi, që kishte ruajtur populli shqiptar gjatë shekujve, me gjithë kushtet e vështira të pushtimit të huaj. «Dashuria për atdhe — shkruante ajo — ka qenë gjithmonë *veçoria më kryesore e shqiptarit* (nënvizimi — A.F.). Shqipëria në të gjitha kohët ka qenë vendi i heronjve. Kombi shqiptar është një popull i fortë, i fuqishëm posi shkëmbinjtë ku jeton».³⁾ Si rrjedhim, populli shqiptar, një nga më të vjetrit të Evropës, meritonte të ishte i lirë dhe në liri t'i zhvillonte më tej aftësitë e veta krijuese.

Përhapja e këngëve popullore arbëreshe *me anë të botimeve të ndryshme* dhe të komentuara e të përkthyer edhe italisht, *ndikoi shumë në opinionin e Evropës* rreth egzistencës së popullit shqiptar me gjuhë, histori dhe tradita të një populli liridashës, që kishte luftuar gjithnjë për liri e pavarësi.

Një rëndësi të veçantë pati vëllimi *Raccolta di Canti popolari di poemi albanesi* (Përmbledhje këngësh popullore dhe rapsodi poemash shqiptare), që botoi më 1871 Zef Jubani (1818-1880). Kjo është e para përmbledhje folkloristike, që u botua nga dora e një shqiptari, me tekste të mbledhura brenda kufijve të Shqipërisë. Autori i saj, Zef Jubani, është një nga përfaqësuesit më të shquar të lëvizjes kombëtare në Veri. Ai, i tërhequr nga traditat patriotike dhe revolucionare të popullit tonë, iu vu mbledhjes së folklorit të vendlindjes, Shkodrës dhe malësisë së Veriut. Vlera e veçantë e kësaj përmbledhjeje qëndron, më shumë, në parathënjën, në të cilën Jubani parashtron në mënyrën më të qartë kërkesat e borgjezisë së re shqiptare për reformat ekonomike, shoqërore e politike. Duke përshkruar gjendjen e vajtueshme ekonomike, shoqërore e kulturele, ku e kishte lënë sundimi i huaj popullin shqiptar, Zef Jubani kritikonte ashpër ligjet dhe gjykatat turke, që ishin shkaktarë të një gjendjeje ku sundonin «*arbitrariteti dhe angaritë*». Ai dënonte qeveritarët turq, të cilët gjoja për të luftuar zakonin barbar të hakmarrjes, përdornin mjete edhe më barbare.

Këngët popullore që jepen në këtë vëllim, sado që në një numër të kufizuar, janë të ndryshme: trimërie, dasme, vaje etj. Midis këngëve historike spikasin këngët që paraqesin hovet e mëdha patriotike të popullit shqiptar, luftrat e ashpra që u bënë kundër turqve në kohën e Kara Mahmut Pashës, më 1835, kundër Hafiz Pashës etj.⁴⁾

Figura më e shquar dhe më e rëndësishme në fushën e botimeve folklorike në shek. XIX, është Thimi Mitkua, i cili çau gjëresisht rrugën në njohjen e vlerave artistike e morale të popullit, në zbulimin e traditave, zakoneve, këngëve dhe pasurive të tjera folklorike të krijuara nga masat punonjëse. Mitkua ka hyrë në historinë e letërsisë sonë si babai i folkloristikës shqiptare.

Thimi Mitkua zhvilloi një veprimtari të madhe e të frutshme për mbledhjen e folklorit shqiptar, si dëshmi jo vetëm e gjenisë krijuese të popullit, por edhe të *unitetit kombëtar* të formuar gjatë historisë. Ai na ka lënë një material të gjërë dhe shumë të vlefshëm folklorik të mbledhur me zell e me dashuri gjatë një periudhe prej afro 30 vje-

3) Dora d'Istria, *Kombësia shqiptare pas këngëve popullore* (përkthim) f. 40-41.

4) *Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar (1635-1912) I*, Tiranë, 1961, f. 235.

tësh. Një pjesë e mirë e këtyre materialeve pa dritën e botimit, po edhe një pjesë e madhe mbeti nëpër raftet e arkivave të ndryshme.

Midis materialeve të botuara, vendin kryesor e zë «*Bleta shqiptare*». Kjo vepër e rëndësishme, që përmbledh, siç e përcaktoi Da Rada «*thelbin e trashëgimisë së ruajtur nga jeta heroike e kombit*», u botua më 1878.⁵

Botimi në këtë vit i «*Bletës shqiptare*» nga Thimi Mitkua pati një rëndësi të veçantë politike e patriotike. Kongresi famëkeq i Berlinit (1878), nën presionin brutal të shteteve të mëdha kapitaliste, vendosi gjymtimin e atdheut tonë, bile ai shkoi aq larg sa që me gojën e kryetarit të kongresit, princit Bismark, i mohohej gjer egzistenca e tij si komb. Nga ana tjetër, Porta e lartë, fill pas shpërndarjes së Lidhjes së Prizrenit në Shqipëri, mori masa të rrepta për shtypjen e qëndresës luftarake të popullit shqiptar. Autoritetet turke filluan të luftonin përhapjen e ndjenjës kombëtare shqiptare, që kishte bërë hapa shumë të mëdha përpara.

Një përmbledhje këngësh popullore të tilla, në rrethanat historike, në të cilat ndodhej populli ynë atëhere, — i panjohur e i papërfillur në arenën ndërkombëtare, i mbytur përbrënda nga propaganda armiqësore e Stambollit dhe e qarqeve shoviniste të vendeve fqinje — *formonte një dokument politik me rëndësi*, sepse: në një anë dëshmonte për të kaluarën heroike të popullit tonë, për gjakun e derdhur në luftat shekullore për liri, si rrjedhim — për të drejtat e ligjshme të tij për të qenë i lirë dhe sovran — në anën tjetër, luante një rol të dorës së parë për edukimin patriotik të masave popullore.

Mitkua përpiqet, me anë të «*Bletës shqiptare*», të ngjallë tek bashkatdhetarët ndjenjën e dinjitetit kombëtar. të fusë në luftën shekullore të popullit tonë perspektivën e çlirimit kombëtar. Këtë ai e bën bile edhe në shënimet e këngëve popullore të botuara në «*Bletën shqiptare*». Pothuajse çdo këngë historike shoqërohet me shënime, që nxjerrin në pah energjitë e mëdha të kombit, qëndrimin krenar dhe mospërfillës të shqiptarit ndaj pushtuesve turq, luftat e tij heroike, nga ana tjetër, shfrytëzimin, pabesitë, grackat, që i kurdisnin pushtuesit e egër otomanë popullit tonë.⁶

Thimi Mitkua ka botuar shumë këngë në «*Bletën shqiptare*», që tregojnë dashurinë dhe vëllazërinë e popullit shqiptar. «*Shqiptari duke dashur pafund atdheun e tij do edhe bashkatdhetarin e tij, edhe kur ai është në tjetër fe, sepse fenë e ka në vend të dytë, kur puna është për atdheun e përgjithshëm*».⁷ Kapitulli më me rëndësi në këtë mbledhje, nga ana patriotike, është, padyshim, ai i këngëve të trimërisë, që së bashku me shënimet historike të autorit, formojnë një burim të rëndësishëm për ngjarjet kryesore, që u zhvilluan në vendin tonë gjatë shek. XVIII dhe XIX. Këto këngë janë gjithashtu një dokument i shkëlqyer i forcës, i vitalitetit, i patriotizmit dhe i ndjenjave liridashëse të popullit tonë, një dëshmi e gjallë e përpjekjeve të tij shekullore për të shkundur zgjedhën e huaj. Në këtë kapitull janë mbledhur me kujdes këngët që tregojnë akte heroizmi, kryengritje masive të armatosura, lufta që kanë mobilizuar me mijëra burra kundër sundimit turk, nga të gjitha anët e atdheut. këngë ku spikasin vetitë e larta morale të shqiptarit: guximi, burrëria, vetmohimi, optimizmi.

5) *Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar, (1635-1912)* I, Tiranë 1961, f. 12.

6) Q. Haxhihasani, *Thimi Mitko*, Tiranë 1962, f. 60.

7) *Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar (1635-1912)* I, Tiranë 1961, f. 12.

Tekstet folklorike, këngët popullore, përrallat, proverbat etj. *sillnin gjuhën e masave, të popullit të thjeshtë*, një gjuhë të kulluar, e cila kishte dallim të madh nga ajo që flitej prej disa qarqeve, që ishin afër ose në marrëdhënje të drejtpërdrejta me pushtuesin, me administratën ose institucionet kulturore të tij, me rrethet fetare. Pra, me anë të kësaj përmbledhjeje, ai do t'iu japë nxitje bashkatdhetarëve shqiptarë, që të kulturohen dhe të studjojnë gjuhën e tyre amëtare, e cila «është ushqim i parë e i përbashkët që i jep gjallëri popullit.»⁸ Siç shihet nga këto fjalë, ai ka parasysh një nga parullat më kryesore të politikës së rilindasve: *çështjen e gjuhës amëtare*.

«Bleta shqiptare» u bë një mjet propagandistik i rëndësishëm, që shërbeu, së bashku me veprat e tjera letrare të shkrimtarëve të Rilindjes, në mbajtjen gjallë të traditave kombëtare, në forcimin e ndër-gjegjes patriotike dhe të luftës së popullit tonë për çlirimin kombëtar. Në fushën politike kjo përmbledhje i shërbeu lëvizjes kombëtare si një pohim i fuqishëm i egzistencës së lashtë të një populli me tradita të mëdha historike, i së drejtës së tij të ligjshme për të qenë i lirë dhe i pavarur.

Jehona e «Bletës shqiptare» dhe veprimtaria e Mitkos në fushën e folklorit u ndie edhe jashtë. Drejtori i organit akademik *Acta Comparationis Litterarum Variarum* i quajti këngët historike të Mitkos, në thelbin e tyre, si një poezi politike të mirëfilltë. Duke u nisur nga këto materiale, ai ngrihet kundër vendimeve të padrejta të kongresit të Berlinit «Çfarë parimesh mund të përlijin vendimet e këtij kongresi, që i mohon një populli me tradita të tilla të drejtën e egzistencës?»⁹

Folkloristët e huaj u njohën, nëpërmjet «Bletës shqiptare», me folklorin e njërit prej popujve të lashtë të Ballkanit; ajo zgjoi një interes të madh për kërkimet e mëtejshme dhe gjuhëtarët e bënë objekt të studimeve të tyre albanologjike.

Botimet folklorike në shekullin XIX ndihmuan për gjallërimin e ndjenjave patriotike, për fuqizimin e vetëdijes kombëtare dhe për popullarizimin e çështjes shqiptare në një plan ndërkombëtar.

Résumé

LES PUBLICATIONS FOLKLORIQUES ALBANAISES AU XIX^e SIECLE MANIFESTATION DE LA CONSCIENCE NATIONALE

L'auteur examine, dans son exposé, la portée qu'a eu la littérature folklorique au XIX^e siècle pour le réveil de la conscience nationale.

D'éminents folkloristes albanais comme de Rada, Zef Jubani, Thimi Mitko, et d'autres, ont donné une contribution féconde par leurs publications folkloriques à rendre populaire la question albanaise sur l'échiquier international.

8) *Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar (1635-1912)*, I, Tiranë 1961, f. 9.

9) *Revue des deux mondes*, 21 gusht 1879 (cit. sipas Th. Mitkos Tiranë, 1961, f. 27).

Les folkloristes albanais ont été guidés, essentiellement, dans leur activité éditrice, par des buts politiques et patriotiques. De Rada évoquait dans son recueil folkloriques: *Rhapsodies dun poème albanais*, le temps héroïque de Skanderbeg comme modèle pour les Albanais du XIXe siècle.

La production la plus importante du XIXe est la *Bleta shqiptare* (L'abeille albanaise) de Thimi Mitko. Sa parution en 1878 représente une belle traduction du génie poétique albanais, à une époque où au Congrès de Berlin était nié purement et simplement à notre peuple même l'existence nationale, et où des prétendus spécialistes étrangers faisaient accréditer à un public crédule toutes sortes de sottises contre l'Albanie. La *Bleta* de Mitko prouvait ainsi de la façon la plus brillante qu'en Albanie vivait toujours et se développait sans cesse une littérature populaire, qui faisait état de hautes qualités artistiques.

L'auteur souligne la question de la valeur éducative et artistique qu'ont continué à avoir ces productions aussi plus tard, en servant comme modèles pour d'autres glaneurs et d'autres éditeurs du trésor populaire.